

NGA HOMERI TE VIRGJILI, NGA BAJRONI TE KADAREA, LETËRSIA SI UDHËRRËFYES I ITINERARËVE GJEOGRAFIKE DHE KULTURORE

Prof. Dr. SAVERINA PASHO

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

saverina.pasho@unitir.edu.al

ABSTRACT

Literary works have undoubtedly been the first tourist guides, long before the term tourist came into existence. The great writers were in a way the first travelers / tourists who discovered the various peoples and countries and wrote about them. More specifically, those who initiated the Grand Tour, which reached its height from the mid-18th century until the beginning of the 19th century, have the merit of shedding light on unknown or little-known civilizations, countries, and arts. This is how Lord Byron could have incited great curiosity about Albania, followed by artists and researchers who, with their impressions, produced an entire literature of travel as well as many tourists. Even today, when tourism has been highly democratized, literature continues to generate the interest of the simple tourist about the culture of the country of destination and that country's literature remains an essential guide. This is how Kadaré's work attracts a large number of tourists who do not only aim to discover the physical territory of Albania, but mostly, to get acquainted with the anthropological territory of his novels.

Keywords: literature, tourism, Kadaré's work, anthropological territory, guide

Ne e dimë se antropologjia ka kohë që merret me fiksionin dhe mitet për të shpjeguar natyrën njerëzore dhe shoqërinë, ndërsa shkencat e tjera madje edhe ato sociale nga një këndvështrim tradicional

pozitivist priren të analizojnë vetëm faktet reale, në dëm të realiteteve imagjinare apo simbolike.

Nga kjo pikëpamje, industria e turizmit shihet më shumë e lidhur me shkencat ekonomike sesa me letërsinë. Por ne dimë gjithashtu se sipas përkufizimit turizmi ndodhet në pikëpjekje të disa fushave e disiplinave.

Prej disa dhjetëvjeçarësh, turizmi ka filluar të shihet i lidhur fort jo vetëm me potencialet natyrore të vendit por edhe me kulturën dhe trashëgiminë imateriale. Turisti aktual është po aq i interesuar të zbulojë një territor fizik sa edhe një territor metafizik që lidhet me imagjinaren kolektive e praktikat kulturore të një vendi. Këtu letërsia përdoret si një mjet për të vënë në dukje, me një saktësi gati antropologjike, lidhjen ndërmjet dimensioneve të ndryshme të asaj çka quhet «territor».

Një analizë pragmatike e përdorimit të letërsisë do të çonte ashtu sikundër ka ndodhur jo radhë, në zbulimin e itinerareve turistike të kalkuara mbi itinerare letrare apo mbi arealin e imagjinare kolektive popullore. Në studimet anglo-saksone për turizmin flitet për turizëm letrar qysh prej vitit 1990, ndërsa në Francë pothuaj nuk flitet qartas për të përpara studimit të Aurore Bonniot-Mirloup, *Imaginaire des lieux et attractivité des territoires : Une entrée par le tourisme littéraire : Maisons d'écrivain, routes et sentiers littéraires*, në 2016.

Pavarësisht këtyre vërejtjeve ne e dimë se në zanafillë të zbulimeve të mëdha që më vonë janë kthyer në destinacione turistike nga më tërheqëse janë shkrimet e autorëve të ndryshëm, në formën e letërsisë fikzionale të mirëfilltë apo të letërsisë së udhëtimit, mes të cilave ka sigurisht shumë elemente dalluese e mbi të gjitha, vërtetësia : nëse letërsia e mirëfilltë ajo e fiksonit të vendos në një univers areal, e dyta është shpesh një dëshmi e vërtetë me vlerë dokumentare. Gjithsesi edhe e para nuk ka munguar të çojë drejt zbulimesh të mëdha, Le të përmendim rastin e arkeologut gjerman Heinrich Schliemann që u nis për në Turqi, në fund të shekullit 19-të me një ide eksentrike për të kërkuar Trojën antike të kënduar nga Homeri në poemat epike *Iliada* dhe *Odiseu* të shek.VIII p.e.s. Dhe ia doli. Hisarliku, në Turqi, njihet sot nga të gjithë si kuadri apo territori i epopeve homerike.

Po kështu, Ugolini mundi ta identifikonte Butrintin përmes *Eneidës* së Virgjilit.

Kjo u festua me një ngjarje të jashtëzakonshme kulturoro-turistike : kroçera virgjiliane, në 15 shtator 1930, në bordin e anijes Aquileja ku pasagjerët kishin fatin të kishin për guidë vetë Ugolinin.

Aktualisht, në Brindisi ka marrë formë një projekt i quajtur *La Rotta di Enea*, që rimerr rrugën që përshkoi Enea dhe kalon nëpër Turqi, Greqi, Shqipëri, Tunizi dhe Itali, me 21 qëndrime kryesore në vende sugjestive të qytetërimit mesdhetar

Për të kaluar në epoka më të vonshme mund të përmendnim ndikimin e madh të shkrimtarëve të huaj romantikë që ndërmorën le Grand Tour d’Orient, në njohjen e Shqipërisë. Shqipëria dhe personazhe të shquara të saj si Skënderbeu apo Pashai i Janinës do të hynin në letërsi përmes Bajronit dhe të tjerë shkrimtarë si V.Hugo apo Lamartini. Shqipëria e kënduar nga Bajroni në poemën e tij të famshme *Pelegri nazhi i Child Harold*, është sigurisht, një Shqipëri romantike e hyjnizuar, por në sajë të kësaj vepre vendi ynë u fut në itineraret e Grand Tour-it. Gjatë shekullit XIX dhe në fillimet e shekullit XX referencat bajroniane do të frymëzonin një numër të madh udhëtarësh evropianë të vizitonin Shqipërinë. Ky ndikim i madh letrar u përkthye në udhëtimet dhe veprat e shquara mbi Shqipërinë si ato të Edward Lear-it, Edith Durham-it, Isadora Duncan.

Sot, ato vazhdojnë të ndikojnë me qindra turistë që duan të ndjekin itinerarin bajronian në jug të Shqipërisë kaluar mbi kalë. Kjo bëri që në vitin 2011 Auron Tare të krijonte për herë të parë një itinerar historiko-turistik mbi kalë duke ndjekur gjurmët e lord Bajronit përmes luginës së Drinos dhe vargmaleve të Lunxhërisë, në jug të Shqipërisë.

Turizmi letrar është një aspekt i turizmit kulturor, i cili është zhvilluar shumë këto vitet e fundit meqë kultura sikundër thotë Françoise Luchini, është bërë «njëkohësisht aspiratë e përligjur e më të thjeshtit midis nesh dhe një instrument aktual për zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të qyteteve tona».¹

Karakteristika e turizmit letrar është se ai ofron për turistin një territor përmes letërsisë. Kështu vendet mund të kthehen në mbartës të një kulture, të një identitetit dhe një historie duke tërhequr turistin vendas apo të huaj edhe për vlerat e trashëgimisë imateriale. Paralelisht, qytetet dhe peizazhet janë tradicionalisht burime të

¹ Françoise Lucchini, *La culture au service des villes*, Paris, Anthropos, 2002, p. 1.

letërsisë së udhëtimeve apo poemave që i këndojnë bukurisë së tyre. Përshkrimet, metaforat, imazhet romaneske të këtyre vendeve tërheqin vazhdimisht vëmendjen e turistëve që interesohen jo vetëm për territorin fizik por edhe për legjendat apo historitë që ndërtojnë një territor shpirtëror dhe ndonjëherë është e çuditshme të konstatosh se si «disa pelegrinazhe letrare përcaktojnë lëvizje të popullsisë dhe një aktivitet ekonomik po aq të rëndësishëm sa pelegrinazhet fetare» (rasti i qytetit të Gjirokastrës).

Ka dy mënyra se si një autor apo një vepër letrare përdoren për të promovuar turizmin kulturor. I pari dhe më i thjeshti është ai që ndjek gjurmët e një autori, vendlindjen e tij, shtëpinë që zakonisht kthehet në muze i hapur për publikun ose në bibliotekë për qytetin. Të tilla në rastin e Kadaresë kemi dy: shtëpinë muze të Gjirokastrës, e cila u rindërtua sipas arkitekturës së saj të dikurshme dhe atë të Tiranës, në rrugën e Dibrës, e cila përmban edhe një bibliotekë modeste të shkrimtarit si dhe dorëshkrime e dokumente që jo vetëm mund të shuajnë kureshtjen e turistëve, por mund të ndihmojnë edhe studiuesit në hulumtimet e tyre.

Një mënyrë tjetër, shumë më interesante, është ajo e tërheqjes së turistëve përmes imazhit të qyteteve ashtu sikundër del nga shkrimi romanesk. Ky është një imazh sa tërheqës aq edhe i sinqertë apo i paqëllimtë, në kuptimin se autori nuk nisët nga ideja për të ndërtuar një imazh të caktuar të cilin do ta shiste sikundër bën autori i një guide, apo do ta ngarkonte me paragjykime dhe mbresa personale sikundër ndodh me letërsinë e udhëtimeve (sikundër dëshmojnë dy raste të studiuar më parë nga autorja e kësaj kumtese, përmes shkrimeve të Pouqueville-it dhe Edward Lear-it për Shqipërinë)

Nga ana tjetër ekziston edhe një turizëm që ndjek gjurmët e autorit në një vepër, ku turisti është i prirur të shkojë për të vizituar dhe rigjetur vende, peizazhe që kanë qenë dekor apo vendngjarje të romaneve të tij të preferuar.

Zhvendosja fizike, udhëtimi në peizazhet, vendet, ndërtesat e cituara në një vepër letrare, mundësojnë një qasje më ndjesore, më të rrokshme nga shqisat nga çka mund të imagjinohet përmes leximit. Ky lloj poroziteti midis territorit real dhe atij të veprës ndonjëherë është një argument marketingu ndonëse nuk përmendet turisti si i tillë. Në fakt, është thjesht një udhëtar (kalimtari siç shkruhet në *Kronikë në gur*)

i cili është kaq i zhytur në faqet e romanit sa vetë vendet dhe peizazhet nisin e transformohen.

Shpesh disa qytete bëhen kaq mbresëlënëse vetëm në saje të një vepre letrare saqë kjo e fundit bëhet pjesë e trashëgimisë dhe e identitetit të qytetit dhe citohet si referencë në fletëpalosjet dhe guidat turistike siç ndodh për shembull me Gjirokastrën që përveçse citohet si qyteti i gurtë, shtohet gjithashtu se është vendlindja ose qyteti për të cilin Kadarea shkruan në romanin «Kronikë në gur» dhe vendet e përmendura në roman si *Qafa e Pazarit, Sokaku i të marrëve, fusha e dikurshme e aviacionit, avioni i rrëzuar dhe sidomos Kështjella* janë itinerare të pashmangshme dhe të frymëzuara drejtpërsëdrejti nga romani. Le të citojmë një pasazh që në hyrje të romanit për të kuptuar se si mund të shërbejë shkrimi romanesk si një kartolinë për qytetin dhe se si mund të ngjallë admirimin e një lexuesi-turist potencial:

«Ky ishte një qytet i pjerrët, ndoshta më i pjerrëti në botë që kishte thyer të gjitha ligjet e urbanistikës. Nga shkaku i pjerrësisë së madhe ndodhte që në nivelin e pullazit të njëres shtëpi gjendeshin themelet e tjetrës, dhe me siguri, ky ishte vendi i vetëm në botë ku kalimtari po të rrëzohej, në vend që të shembej në gropën ndanë udhe, mund të binte në pullazin e ndonjë shtëpie të lartë.» (Kadare, I., 2000, f.14)

Ose

«Ishte me të vërtetë një qytet shumë befasues, Ti mund të ecje rrugës dhe po të doje, mund të zgjatje pak krahun e të vije kësulën tënde mbi majën e një minareje». (Idem)

Nuk besoj se ndonjë reklamë promovuese do të ngjallte më shumë interes e më shumë kureshtje për Gjirokastrën sesa këto pasazhe që hapin romanin “Kronikë në gur.”

Në rastin e shkrimit romanesk, kartolina e qytetit të përshkruar nga autori është larg qasjes së letërsisë së udhëtimeve dhe për më tepër është shumë herë më magjepsëse pasi aty hyn fuqia e figuracionit letrar si dhe ngarkesa e tramës dhe e përjetimit të autorit. Kështu letërsia përdoret si një mjet për të vënë në dukje me saktësi antropologjike lidhjen midis dimensioneve të ndryshme që mund t’i quajmë «territore». Në këtë kuptim kemi atë përfitim që antropologët e quajnë çështje territoriale çka nënkupton një shumësi dimensionesh nga ai individ-

ual te më kolektivi me të gjitha qasjet psikoanalitike, historike, fetare, politike, etj.

Kështu përmes romanit, apo në mënyrë më të specifikuar romanit të Kadaresë “Prilli i thyer” që do të na shërbejë për të ilustruar analizën tonë, ne do të realizojmë një eksplorim sistematik të nocionit të territorit në të gjitha kuptimet e tij. Tani nuk jemi aq në një territor fizik (ndonëse edhe ky nuk mungon) sesa në një territor metafizik e areal. Në fakt, autori na përgatit për këtë gjë ndërsa shkruan:

“Malësorët e vërtetë janë aty në Rrafsh, i kishte thënë ai një natë, duke bërë me dorë në një drejtim që më tepër tregonte lartësinë qiellore, sesa ndonjë pikë të horizontit, thua se Rrafshi verior ndodhej në qiell e jo në tokë”. (Kadare, I., 2003, f.64)

Territori fizik është ai i Mirditës, Oroshit dhe Bjeshkëve të Namuna. Këto të fundit ndonëse përbëjnë një territor fizik material e real mbeten ende të papërcaktuara mirë gjeografikisht në roman.

Sipas Fjalorit enciklopedik shqiptar të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (1985) Bjeshkët e Namuna njëjtësohen si “kuriz malor në Alpet Shqiptare, rrethi Shkodrës...”

Në një reportazh të saj, me titull “Në malet e malsorëve” (“Dans les montagnes des malissorës”), botuar më 9 qershor 1924 në *Journal de Genève*, Noëlle Roger, pasi flet për malet në brigjet e Liqenit të Shkodrës e të Drinit dhe për malet e Mirditës, shkruan se këto mbështesin një “labirint të pafund vargmalesh e luginash të egra, i cili në hartat e paraluftës mban emrin e Bjeshkëve të Nëmura” (në origjinalin frëngjisht *Monts Maudits*). Roger i vendos “Bjeshkët e Nemuna” në veri të Drinit.

Mungesa e saktësisë gjeografike, nuk e zbeh aspak magjepsjen. Edhe në këtë roman kemi diçka që ngjason shumë me një ftesë për të vizituar këtë territor apo pothuajse me një spot publicitar të vjetër dhe të kthyer pas në kohë:

Ja një citim kinse i bërë në një gazetë të asaj periudhe :

“Një befasim i këndshëm: Shkrimtari Besian Vorpsi me gruan e tij të re, Dianën, vendosën ta bëjnë muajin e mjaltit në Rrafshin e Veriut”. (Kadare, I., 2003, f.60)

Por Rrafshi është ende territori i Kullave dhe Alpeve. Alpet vazhdojnë të jenë një atraksion turistik i rëndësishëm në Shqipëri dhe *Kullat* përmenden në çdo guidë turistike për Shqipërinë, vendase apo të huaj.

“...në Alpe ishte ende ftohtë dhe kullat epike ishin të gurta.” (Idem f.61)

Zona veriore është padyshim një destinacion shumë tërheqës për turistët e huaj, jo vetëm për bukuritë natyrore por edhe për ngarkesën emocionale, simbolikën dhe eposin që mbart ky vend i mbushur me legjenda.

Mirëdita që është territori fizik i romanit “Prilli i thyer” është gjithashtu nga një qasje antropologjike territori i gjakmarrjes, i besës, që ende ngjall kureshtje për turistët dhe figuron në guidat turistike qoftë edhe si një rekomandim i frymëzuar nga stereotipet se sipas një tradite të vjetër të rregulluar me një ligj tradicional si kanuni është e rrezikshme t’i fyesh apo ngacmosh shqiptarëve gruan apo motrën.

Por është interesante të konstatojmë në rrjetet sociale se shumë turistë vendas pyesin për vendndodhjen e Oroshit, nëse aty ka mbetje të kullës së ngujimit, kisha të vjetra, etj. Këto kureshti që kërkohen në këtë territor kanë të bëjnë me orientimin nga leximi i veprës së Kadaresë ashtu sikundër aluzionet në këtë roman i drejtojnë turistët drejt një vendi ku mund të gjejmë sigurisht ndërtesat karakteristike kullat e gurta dhe kisha të vjetra, dhe për këto të fundit turisti nuk do të mbetet i zhgënjyer sepse në Mirditë do të gjejmë Kishën e Manastirit të Rubikut, një monument kulture i kategorisë së parë që daton në shek XII-XIII.

Ajo që ka rëndësi është se leximi i një vepre romaneske ka një forcë evokative më të madhe se sa një guidë turistike dhe mund ta drejtojë lexuesin drejt zbulimit të vendeve dhe kulturave të ndryshme. Prandaj themi se letërsia mbetet një udhërrëfyes i pashmangshëm në zbulimin e itinerareve turistike ashtu sikundër këto të fundit janë frymëzuese për shumë autorë dhe ushqejnë pareshtur letërsinë e më specifikisht letërsinë e udhëtimeve.

BIBLIOGRAFIA

Referime artikujsh

GARGANO OLIMPIA (2021) : Le voyage en Albanie d'Isadora Duncan, entre autobiographie et fiction romanesque, in Loxias <http://revel.unice.fr/loxias/index.html?id=6864>

HEINICH, N. (2002). Les dimensions du territoire dans un roman d'Ismaïl Kadaré. Sociologie et sociétés, 34 (2), 207–218. <https://doi.org/10.7202/008139ar>

Referime librash

LEAR, EDWARD, (2008), *Edward Lear në Shqipëri: Ditar udhëtimesh 1848-1849*, Tiranë, Botime Plejad

POUQUEVILLE, F.-C.-H.-L., (1826), *Voyage de la Grèce*. Paris : Firmin Didot Père et Fils.

ELIAS, NORBERT (1973), *La civilisation des mœurs*, Paris, Calmann-Lévy

RAMA, LUAN, 2005, *Santa Quaranta: gërsheti i prerë i Isadora Dulkanit*, Tirana, Argeta,

KADARE, ISMAIL, (2000), *Kronikë në gur*, Tiranë, Botime Onufri

KADARE, ISMAIL, (2003), *Prilli i thyer*, Tiranë, Botime Onufri.